

LANGUAGE AND IDENTITY IN THE OPTICS OF FOREIGNERS GJUHA DHE IDENTITETI NË OPTIKËN E TË HUAJVE

Emine SHABANI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract

Since ancient times scholars and kings have been curious to know which language is older. Language, this foundation of identity, a symbol of Albanians, can not stay out of the interest of Albanian scholars, but above all foreigners such as Leibnitz, Mathurin Veyssiere La Croze (Matura, Vesijer la Kroz), L. Lamouche (Leon Lamosh), George von Hahn, Frantz Bopp, Norbert Jokli, Tagliavini, Gustav Mayer, Norbert Jokly, etc., who studied the origin and antiquity of the Albanian language, based on archaeological facts and arguments and ancient manuscripts. But the study and above all the love for the language, will not escape the pen of Albanian poets, such as Fishta, Naimi, Samiu, Noli, Mjedja, Vasa, Poradeci, they weave verses that climb like a spiral towards the sky, as a testament of the continuity of the nation, with a prominent emphasis on raising national consciousness.

Their poetic world sails in a spirit of patriotism, where the love for the land is felt, the people, where they give orders to shake the imaginations that are foreign and annoying, for them, they live in a war ecstasy, strengthen the limbs, shoot, drive and the wolves are frightened, they do not bow before the enemies and so they move forward with pride ... Nothing can stop them from the ideal that has conquered them. These poems are a faithful reflection of the complex vitality, of the lively and noble vitality to preserve those original qualities, to fulfill their mission! Their poems are captivated by a sincere inspiring lyricism, which is expressed with bright images of the past that is today but also the future.

Keywords: *Language is the basic identity, a symbol of Albanians, melodic and rich!*

Përmbledhje

Që nga antika dijetarë e mbretër, kanë qenë kureshtarë të dinë se cila gjuhë është më e vjetër. Gjuha ky themel identiteti, simbol i shqiptarëve, nuk mund të qëndrojë jashtë interesit të studiuesve shqiptarë, por para së gjithash edhe të huajve siç janë Leibnitz, Mathurin Veyssiere La Croze (Maturëa, Vesijer la Kroz), L. Lamouche (Leon Lamosh), George von Hahn, Frantz Bopp, Norbert Jokli, Tagliavini, Gustav Mayer, Norbert Jokly, etj, të cilët e studiuin prejardhjen dhe vjetërsinë e gjuhës shqipe, bazuar në faktet dhe argumentet arkeologjike dhe dorëshkrimet antike të stërlashta. Por studimi dhe mbi të gjitha dashuria për gjuhën, nuk do t'u ikë as penës së poetëve shqiptarë, si Fishta, Naimi, Samiu, Noli, Mjedja, Vasa, Poradeci, ata i thurin vargje që ngjiten si spirale drejt qiellit, si testament i vazhdimësisë së kombit, me theks të spikatur për ngritjen e vetëdijes kombëtare.

Bota poetike e tyre lundron në një frymë atdhedashurie, ku ndjehet dashuria për tokën, njerëzit, ku japin porosi për shkundjen e përfytyrimeve që janë të huaja e të bezdisshme, për ta, ata jetojnë në një ekstazë luftarake, forcojnë gjymtyrët, gjuajnë, përzënë e trembin ujqërit, s'përkulen para armiqve dhe kështu ecin përpara me krenari...Asgjë si ndal nga ideali që i ka pushtuar. Këto poezi janë një pasqyrë besnike e gjallërisë komplekse, e vitalitetit të gjallë e fisnik për ti ruajtur ato cilësi origjinale, për ta përmbushur misionin e tyre! Poezitë e tyre janë të kapluara nga një lirizëm i çiltër frymëzues, që shprehen me imazhe të shndritura për të kaluarën që është e sotmja por edhe e ardhmja.

Fjalët kyçe: *Gjuha themel identiteti, simbol i shqiptarëve, melodike dhe e pasur!*

Gjuha dhe identiteti në optikën e të huajve

E para ishte fjala, në të ishte jeta-drita e njeriut. Dhe drita shkëlqeu në errësi por errësira nuk e kuptoi. Në mes të shekullit të kaluar, mjeshtëria e fjalës dhe vargut të Lasgush Poradecit, arriti maksimumin e rrjedhshmërisë dhe fuqisë poetike. Poet disident, i cili e luftoi një sistem të mykur fund e krye, që e dëmtoi bërthamën e identitetit të një kombi-gjuhën, të cilën e nënvizon në poezinë kushtuar *Naim Frashërit* dhe Këngë pleqërishte, përmes lirikës së tij gnomike, me fjalët-armë të mprehta e të goditura, të rimuara, me ngjyime psikologjike, të thella e të individualizuara, që shprehin forcën shpirtërore të poetit.

Gjetjet figurative të Poradecit janë të dhembshura, të fuqishme e të urta dhe herë-herë kanë krahë dhe e ngrenë këtë element të shenjtë në qiell pranë Perëndisë: “Shpirt i shent i kombit, zjarr ku djeg me dritë, shpat’e ndritur e lirisë, Verb i Perëndisë. Poeti i liqenit, merr shembull arketipin e tij Naim Frashërin. Duke skicuar karakterin naimian, ai sjell motivin e lashtë të paraardhësve tanë, me shprehjet **këngë që pat qarë me harmoni divine**,⁷³ në këtë vend të pambrojtur godet fati, ai është fshehtësirë që kalon me fat në duar, është njollë e zezë, që mbetet pasi shuhet një yll.”⁷⁴

Sikurse Lasgush Poradeci, Jeronim de Rada, Naum Veqilharxhi, Dhimitër Kamarda, Elena Gjika, Naim e Sami Frashëri, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Fan Noli, Mitrush Kuteli, etj...do t’i shkrijnë të gjitha fuqitë mendore për çështjen e gjuhës, historiografisë dhe prejardhjes së lashtë të shqiptarëve. Emri i Naum Veqilharxhit lidhet ngushtë me Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në planin historik, kombëtar, kulturor e letrar. Ai është shtytësi i kësaj lëvizje. Veqilharxhi ka meritë të veçantë për, Letërqarkoren për të gjithë djemtë e pasur e të ditur ortodoksë, (kushtuar Jani Calit).

Ai ishte i pari që ndjeu nevojën e ngutshme të përhapjes së arsimit në gjuhën amtare për të penguar helenizimin e vendit. “Gjuha amtare, shkruante ai, është faktor i rëndësishëm për zhvillimin mendor të fëmijës dhe përvetësimin e shpejtë të njohurive të dhëna në shkollë.” (Parathënie e Evëtarit, 1845). Por si mund të lëvrohej gjuha shqipe pa një alfabet të pranueshëm për shqiptarët myslimanë, ortodoksë e katolikë bashkë? Më 1824 dhe 1825 Veqilharxhi e kishte nisur tashmë punën për një alfabet të tijin me tridhjetë e tre shkronja dhe më 1844 shtypi një abetare shqip prej tetë faqesh.

Ky libër i vogël drejtshkrimi, u shpërnda në mbarë Shqipërinë e jugut, nga Korça në Berat, dhe u prit me shumë entuziazëm. Kjo broshurë u zgjerua deri në dyzet e tetë faqe në një botim të dytë po aq të rrallë në vitin 1845. Për shkak të thirrjes së tij për bashkim kombëtar dhe hartimit të Evëtarit, më 1846, u thirr në Stamboll, u burgos në zandan dhe mendohet se vdiq prej një helmimi nga Patriarku Ekumenik i Kostantinopojës. Një nismëtar i një misioni të shenjtë, u bë martir, i shkrimit shqip, por nuk do të jetë i vetmi.

Pas Veqilharxhit edhe De Rada si një prej dy *dioskurëve të romantizmit shqiptar*, do ta studiojë lashtësinë e kësaj gjuhe dhe do të organizojë dy konferenca ndërkombëtare, për gjuhën shqipe. Megjithëse kishte një traditë shumë të hershme të shkruar, por nevoja për një alfabet unik, ishte e domosdoshme. Romantizmi kjo rrymë e themeluar nga Gëte dhe Herder, në fasadën e tij kishte fokusin në imagjinatën e pakufishme të autorit për të udhëtuar në skajet më të largëta të saj, por prapavija e tij qe shumë racionale: themelimi i gjuhëve standarde dhe formimi i shteteve kombëtare, përkundrajt principatave të shumta që mbizotëronin gjithkund në Europë, është me rëndësi, të përmendim këtu se shteti i parë kombëtar në Ballkan e më gjerë, u formua nga Skënderbeu, Arbëria mesjetare që bashkoi të gjitha principatat e krahinat e banuara me arbërorë.

⁷³ Emine Shabani, *Filozofia e poezisë së Lasgush Poradecit*, University of Korça “Fan S. Noli”, Academy of Sciences of Albania, Institute of Albanology Prishtina, Institute of Linguistics and Literature, Tirana. Korça, pg. 170-178, 2019. e-ISBN: 978-9928-4568-4-7.

⁷⁴ Po aty, f. 5.

Për perëndimin ishte rrymë romantike, për shqiptarët ishte edhe romantizëm dhe rilindje njëkohësisht. Rilindje si feniksi i lashtë nga vet hiri i tij. Veprimtaria e de Radës që e shumanshme, ai ia kushtoi gjithë jetën çështjes së gjuhës dhe krijimeve të tij letrare, etnologjike, estetike e shkencore. De Rada arriti të ketë një forcë të brendshme gati të pabesueshme për të krijuar artin e tij të pavdekshëm, duke pasur prioritet kontributin për gjuhën dhe shkrimin shqip, ai e pati vetëdijen e shqetësuar për të rishpikur Arbërinë. Naim Frashëri sintetizon mbarë përpjekjet historike të popullit tonë. Racionalizmi dhe iluminizmi i tij, janë hallka e domosdoshme që vihet ndërmjet rropatjeve politike të Lidhjes së Prizrenit dhe vlimeve mbarë shpirtërore të shqiptarëve.

Edhe pse Lidhja e Prizrenit dështon, Naimi, e vazhdon misionin e tij me vendosmëri. E kush më mirë se ai do ta vazhdonte edukimin e popullit, përmes fjalës së bukur. Vepra e tij është poliedrike, gjuha, shkolla e parë shqipe, shkronjat, poezia didaktike për fëmijë, jo vetëm që kontribuoi për ngritjen dhe konsolidimin e tyre, por edhe thuri vargje të bukura, të njohura për kujdesin dhe formën elegante dhe të stërholluar artistike. Ai shkroi tregime dhe vjersha didaktike për Mësonjëtorët e para shqipe. Një grup atdhetarësh që duhej ta takonin në Stamboll mes tyre edhe Sevasti Qiriazi, e cila do ta përshkruajë kështu porosinë që i dha poeti i madh:

“Motrë..., pengime dhe trazime të shumta do të keni në këtë udhë që keni nisur, por si një shqiptarë trime të gjitha i ke për ti kapërcyer. Të gjitha ato çupa e gra, që do të vijnë nën hijen tënde, i frymëzo me ideale të nalta e të vërteta, që të harrijmë një qytetërim të vërtetë, edhe kështu ta bëjmë edhe brezin tonë, të pushtojmë gjithë ato virtyta dashurie, vëllazërie, atdhetarie dhe bashkimi, që karakterizon kohërat e Skënderbeut!”.⁷⁵

Në nëntor të vitit 1884, një djalë i ri shqiptar, me ëndrrën për të ndryshuar kombin, nisët me një karrocë që shkonte për në Korçë, pa e ditur se rrugës i kishin zënë pritë. Në librin Pengu i kaçakëve, Gjerashim Qiriazi rrëfen historinë e vërtetë të rrëmbimit të tij dhe atë që ngjau gjatë atyre muajve sa që peng i tyre. Ishte ai kalvar i dhimbshëm që e nxiti atë për t'i nxjerrë bashkatdhetarët e vet nga errësira. Një rol të jashtëzakonshëm ka luajtur edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881, e cila në krye me Abdyl Frashërin, Sulejman Vokshin, etj, themeloi Komitetin qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombit shqiptar, në Konstantinopojë me synimin që shqiptarët të fitonin një farë autonomie përbrenda Perandorisë Osmane.

Këtë kuvend e hapi Abdyl Frashëri, si përfaqësues i Komitetit qendror nga Stambolli. Vendimet e Lidhjes së Prizrenit, nën emërtimin Kararnameja u miratuan dhe u nënshkruan nga dyzet e shtatë bejlerë shqiptarë më 18 qershor 1878. Një alfabet i vetëm do të thotë, një unitet kombëtar që ishte qëllimi i rilindësve, të njihej kombi ynë nga të tjerët, sepse perandoria osmane kishte bërë ndarjen fetare-etnike dhe ndarjen në katër vilajete që çonte në copëtimin e tokave shqiptare, si një etni multi fetare. Shtrohet pyetja me sa alfabete u shkrua shqipja para Kongresit të Manastirit? Sipas studiuesit Robert Elsie krahas alfabetëve të huazuara, interes paraqesin alfabetet origjinale dhe ai ka gjetur dhjetë alfabete të këtilla.

Një ndër to e hasim në “Dorëshkrimin Elbasanas të Ungjijve”, që sipas Elsie-t, me shumë gjasë është vepra e Gregorit të Durrësit, një figurë e madhe e kësaj periudhe, ai është një dorëshkrim i vogël dhe i vetëm që ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë. Ky studiues në kapakun e dorëshkrimit të Ungjijve vërejtë një vizatim me dymbëdhjetë fjalë të shkruara me një alfabet të ndryshëm nga ai i dorëshkrimit, i krijuar nga njëfarë Todhri Haxhifilipi (1730-1805) nga Elbasani. Në shek. XVII Papa Totasi, mendohet se është autor i një dorëshkrimi, i cili për pamundësi identifikimi të saktë u quajt, “Anonimi i Elbasanit”, dorëshkrimi ka 58 faqe dhe është shkruar me një alfabet origjinal të autorit. Alfabeti i Todhrit u zbulua nga Johan Georg fon Hani (1811-1869), konsulli austriak në Janinë dhe studiues i albanologjisë. Një tjetër është i të ashtuquajturit Kodeksit të Beratit. Ky dorëshkrim prej 154 faqesh, është vepra e të paktën dy shkrimtarëve dhe u hartua midis viteve 1764 e 1798.

⁷⁵ Rexhep Qosja, (1979), *Dialogje me shkrimtarët*, Rilindja, Prishtinë, f. 46.

Dorëshkrimi lidhet me një- farë Kostë Berati. Sipas Robert Elsie-t, në faqen 104 gjejmë dy radhë të shkruara shqip me një alfabet origjinal prej 37 germash të ndikuara, siç thuhet, nga glagolishtja. Kemi të dhëna edhe për një alfabet tjetër në Gjirokastrë nga fundi i shek XVIII dhe fillim të shek XIX, i Veso beut me një sistem grafik prej 22 germash që e zbuloi dhe botoi Hahni. Një tjetër alfabet është nga jugu i Shqipërisë i Jani Vellarait (1771-1823) që gjuhën shqipe e shkroi me këtë alfabet origjinal prej 30 shkronjash me bazë latine e greke.⁷⁶

Rilindja kombëtare kjo periudhë më e ndritshme e jona që solli një numër të madh veprash si traktate politike-filozofike ashtu edhe artistike, gjuhësore, historike e cila do ta kurorëzojë me sukses çështjen e një alfabeti të përbashkët në Kongresin e Manastirit në nëntor të vitit 1908. Alfabeti i shoqërisë Drita të Stambollit i hartuar nga Sami Frashëri fitoi në konkursin e shkronjave, por ky dijetar ishte njëkohësisht edhe babai i gjuhës moderne turke, pasi që hartoi edhe alfabetin e sotëm turk dhe gramatikën e gjuhës moderne të saj, por edhe shumë drama, përkthime dhe Enciklopedinë Botërore në gjuhën turke.

Gjithë përpjekja titanike e rilindësve, për alfabetin, u promovua në Kongresin e Manastirit, cili i filloi punimet nga 14-22 nëntor 1908 dhe mbetet akti i pajtimit të shqiptarëve që duke vendosur për alfabet të përbashkët i hapën rrugë aktit madhështor të Pavarësisë. Ky kongres pati gjithsej 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 23 qytete, shoqëri dhe klube dhe 18 delegatë të tjerë, pa të drejtë vote. Kryetar i Komisionit ishte Gjergj Fishta, nënkryetar: Mit-hat Frashëri, sekretar: Luigj Gurakuqi, anëtarë : Ndre Mjeda, Bajo Topulli, Sotir Peci, Gjergj Qiriazi, Shahin Kolonja, Parashqevi Qiriazi, Grigor Cilika, Hilë Mosi, Thoma Avrami, Fehmi Zavalani, Nyzhet Vrioni, Bajo Topulli, Phineas Kennedy-vëzhgues i kongresit, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Dhimitër Buda, Mihal Grameno, Sami Pojani, Filomena Bonati, Taqi Buda, Petro Nini Luarasi.

Një ndër vendimet e Kongresit të Manastirit ishte ngritja e Shtypshkronjës Shqipe në Manastir nën drejtimin e Gjergj Qiriazit, e cila u bë e njohur anembanë vendit si shpërndarëse e librave dhe gazetave shqipe. Por shpejt qeveria osmane i mbylli të gjitha shtypshkronjat. Më 1911, Xhon Hoxhson, përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike të Kostandinopojës, raportonte: “Të gjitha shkollat shqipe janë mbyllur pa pikë mëshire, kurse përpjekjet ngulmuese për ndalimin e gjuhës dhe zhdukjen e letërsisë shqipe nuk kanë reshtur kurrë. Gjendja e rëndë politike mund të marrë flakë nga çasti në çast. Tashmë shqiptarizmi kishte shpërthyer dhe nuk do ndalej më”!

Studiuesit e huaj për gjuhën shqipe: Interesimi për gjuhën shqipe filloi me filozofin e linguistin gjerman, Leibnitz, i cili iu drejtua mikut të tij Mathurin Veyssiere La Croze (Maturëa, Vesijer la Croz), të cilin e nxiti të merret me studimin e gjuhës shqipe, e cila siç thotë ai: “meriton të studiohet e krahasohet, me gjuhët më të vjetra” dhe “ N.q.s gjendet një gjuhë e veçantë dhe krejt e ndryshme nga sllavishtja, hungarishtja, greqishtja dhe turqishtja, atëherë kjo gjuhë thuhet se gjendet ndër male të Shqipërisë e të Epirit”.⁷⁷

Studiuesit seriozë botërorë e quajnë shqipen si “Një gjuhë krejt në vete (Tagliavini), një ndër gjuhët më të vjetra të Europës, ndër më të vjetrat e më të bukurat e botës (Leibnitz), e cila është një titull bujarie, për popullin që e flet (Leon Lamosh-L. Lamouche), një gjuhë autoktone (George von Hahn), indoeuropiane (Frantz Bopp), që rrjedh nga bashkimi i ilirishtes dhe trakishtes së moçme (Norbert Jokli).⁷⁸

Mjafton të përmendim çfarë ka bërë Stambolli (dhe jo vetëm), në shekullin 19 e në fillim të atij 20 kundër gjuhës dhe alfabetit shqip.

1. Shtëpia botuese Zonja e papërlyeme, e etnëve jezuit e themeluar më 1870, për shumë vjet u detyrua të botonte në fshehtësinë më të madhe.

⁷⁶ Robert Elsie, (2000), *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, f. 389.

⁷⁷ At Giuseppe Valentini, (2013), *Të drejtat e Shqipërisë etnike*, Plejad, Tiranë, f. 99-100.

⁷⁸ At Giuseppe Valentini, (2013), *Të drejtat e Shqipërisë etnike*, Plejad, Tiranë, f. 99-100.

2. Në fillim të shek 20, viti 1904, zinjsh. Durham duke udhëtuar në Shqipëri, arriti në Berat dhe deshi të hyjë në atë qytet, xhandarët ia morën të gjitha librat shqip që kishte me vete, sepse urdhrat e rinj kishin ndaluar qarkullimin e çdo shtypi shqip.⁷⁹

3. Turqit e rinj (dhe jo vetëm), i shpallën një luftë të rreptë gjuhës dhe alfabetit latin dhe pas Kongresit të Manastirit, nuk lanë gur pa luajtur, për të përhapur, gjithkund grindje e përçarje. Ata shpresonin që ta kthenin alfabetin arabisht, ose në të kundërtën do të dështonte veprimtaria e Rilindjes Shqiptare. Por përpjekja që e kotë, sepse shumica e myslimanëve dhe hoxhallarëve, zgjodhën edhe një herë alfabetin latin, ashtu sikurse shprehet edhe Hafiz Ali Korça, për demonstratën e Korçës : Unë isha në këtë demonstratë krah për krah me Gjergj Fishtën, për alfabetin latin dhe madje bëra edhe një lutje për to.

Shqiptarët ruajtën gjuhën e të parëve, e gjuha ruajti kombin shqiptar. Gabriel Louis-Jaray (Gabriel Lui Zhare), në veprën e vetë Shqiptarët, (Les Albanes), shkruan: “Shqiptarët nëpërmjet gjuhës kanë ruajtur individualitetin e tyre etnik”. Gjuha shton D. Comparetti, duke qëndruar në një mënyrë të çuditshme, kundër rrymash të forta e të shumta, që punonin për shfarosjen e saj, pengoi që populli shqiptar të zhdukej, duke u përzier me popuj fqinj, më të fortë se ai. Gjuha shqipe është një shembull i shkëlqyeshëm i vlerës së gjuhës, si element ruajtës i kombësisë edhe atëherë kur kombet kanë bjerrun unitetin e pavarësinë politike të tyre.⁸⁰

Pasi gjuha ka qenë dhe është roja dhe shpëtimi i kombit, do ta duam dhe do ta mbrojmë e do ta lëvdojmë në të gjitha vendet e banuara me shqiptarë. Siç thotë prof. Karl Gurakuqi: “Kjo gjuhë me mijëra vite shprehu mendimin e disa miliona njerëzve të një gjaku me ne, se fati i saj që fati i Shqipërisë, jeta e saj historia jonë, mbretërimi i saj, madhniya jonë. Do ta duam se fjala e saj na del nga fundi i shpirtit bashkë me çdo ndjesi tonën, trazohet me mendimet tona që prej burimit të tyre më të thellë dhe, nuk është vetëm trajtë, kumbim, ngjyrë, por krejt jeta e mendimit tonë. Do ta duam se është ushqimi mendor i yni, fryma e mendjes dhe e shpirtit tonë, sepse është shprehja e vetisë më të madhe të cilësive të veçanta të kombit tonë, fytyra më e gjallë dhe më fisnikja, e gati-gati natyra e vet racës sonë. Do ta duam se është lidhja më e fortë e njësisë sonë si popull, ushtimi e së kaluarës sonë, zëri i ardhmërisë sonë, jo vetëm fjala por edhe qenësia e shpirtit të atdheut. Do ta duam gjuhën shqipe se është e bukur, shumë e vjetër dhe shumë e fuqishme. Fjalët e saj kanë për ne një kumbim, që është si një kuptim i dytë i fshehur, i cili nuk mund të shfaqet në asnjë mënyrë, harmonia e saj na zgjon kujtime të pambarimta ndjesish, vendesh dhe trajtash njerëzore, zanesh dhe theksimesh të njohura të gjallësh e të vdekurish, mendime fytyra dhe vjersha shkrimtarësh të gjallë e të pavdekshëm, që janë bërë një me shpirtin e me gjakun tonë, gjuha shqipe është muzika e ndjesive tona, e dhimbjes, e gëzimit e dashurisë së atdheut, plot me fuqi e ëmbëlsi të mistershme, të cilat nuk mbërrijnë deri te buzët tona, por lëvizin, bredhin dhe bulojnë, në thellësinë e shpirtit si virtyte të fshehta të natyrës sonë”.⁸¹

Referencat

- [1]. At Giuseppe Valentini, (2013), *Të drejtat e Shqipnisë ethnike*, Plejad, Tiranë.
- [2]. Gurakuqi, Karl (1942), *Dashuniya për gjuhën*, në Shkëndija II.
- [3]. Shabani, Emine *Filozofia e poezisë së Lasgush Poradecit*, University of Korça “Fan S. Noli”, Academy of Sciences of Albania, Institute of Albanology Prishtina, Institute of Linguistics and Literature, Tirana. Korça, pg. 170-178, 2019. e-ISBN: 978-9928-4568-4-7.
- [4]. Qosja, Rexhep (1979), *Dialogje me shkrimtarët*, Rilindja, Prishtinë.
- [5]. Elsie, Robert (2000), *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë.
- [6]. Poradeci, Lasgush, (1978), *Vdekja e Nositit*, Rilindja, Prishtinë.
- [7]. Qosja, Rexhep (1979), *Romantizmi I*, Rilindja, Prishtinë.

⁷⁹ At Giuseppe Valentini, (2013), *Të drejtat e Shqipnisë ethnike*, Plejad, Tiranë, f. 102.

⁸⁰ At Giuseppe Valentini, (2013), *Të drejtat e Shqipnisë ethnike*, Plejad, Tiranë, f. 104.

⁸¹ Karl Gurakuqi, *Dashuniya për gjuhën*, në Shkëndija II (1942), f.313-314.